Të maskuar dhe me armë zjarri, tentuan të vidhnin gjatë natës një banesë në Lushnjë, tre në pranga

01 Korrik, 2023 09:55

Madhësia e tekstit:

Një ngjarje e rëndë është parandaluar gjatë natës në një fshat të Lushnjës, ku dy persona kanë tentuar që të grabisnin një banesë.

Ngjarja në fjalë është regjistruar në fshatin Bubullimë. Falë informacioneve në kohë, u kapën në flagrancë në oborrin e banesës ku donin të vidhnin, pa hyrë ende në brendësi të saj, Gentian Bajrami, Ramazan Troka.

Po ashtu u arrestua dhe bashkëpunëtori i tyre, Volter Alushaj, që i transportoi me makinë.

NJOFTIMI I POLICISË

Të maskuar dhe me armë zjarri, tentuan të vidhnin gjatë mesnatës, në një banesë në fshatin Bubullimë, falë informacioneve të marra nga qytetarët dhe mbërritjes së menjëhershme të Policisë, në vendngjarje, kapen në oborrin e banesës ku synonin të vidhnin dhe vihen në pranga 2 shtetas.

Në pranga edhe një 30-vjeçar i cili transportoi këta shtetas në vendngjarje, dhe priste për t'i marrë sërish, pas kryerjes së krimit. Policia sekuestron 1 armë zjarri pistoletë me 1 krehër me municion luftarak, 2 maska, doreza plastike, 10 lidhëse plastike të lidhura në formë prangasih dhe automjetin që drejtonte 30-vjeçari.

Shërbimet e Komisariatit të Policisë Lushnjë, mesnatën e djeshme, menjëherë pas marrjes së njoftimit, nga banorë të fshatit Bubullimë, se kishin paré disa shtetas të maskuar që po lëviznin në drejtim të një banese në këtë fshat, kanë organizuar punën dhe kanë mbërritur në vendngjarje për të verifikuar situatën e njoftuar.

Si rezultat i mbërritjes së menjëhershme të shërbimeve, si dhe ndërhyrjes së organizuar dhe profesionale, në kuadër të operacionit "Momenti", u bë i mundur parandalimi i një vjedhjeje e cila mund të kishte rezultuar me pasoja për jetën e poseduesve të banesës, pasi njëri nga autorët e dyshuar ishte i pajisur me pistoletë.

Për këtë rast, u kapën në flagrancë në oborrin e banesës ku donin të vidhnin, pa hyrë ende në brendësi të saj, dhe u arrestuan shtetasit G. B., 22 vjeç dhe R. T., 29 vjeç, të dy banues në Radostinë, Fier. Gjithashtu, u kap dhe u arrestua shtetasi V. A., 30 vjeç, banues në Radostinë, Fier, pasi nga veprimet hetimore dyshohet se ka sjellë shtetasit G. B. dhe R. T., në vendngjarje, me automjet, dhe po i priste ata në vendin e quajtur "Rotondoja e Kolonjës", për t'i marrë sërish, pas kryerjes së krimit.

Në cilësinë e provës materiale, shtetasve G. B. dhe R. T. iu gjetën dhe iu sekuestruan 1 armë zjarri pistoletë me 1 krehër me municion luftarak, 2 maska, doreza plastike dhe 10 lidhëse plastike të lidhura në formë prangash. Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për veprime të mëtejshme, për veprat penale "Vjedhje me armë", mbetur në tentativë dhe kryer në bashkëpunim, si dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit".

(BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

Etiketa: grabitje | Lushnjë

TË NGJASHME

Grabitë me armë një shumë të madhe paraleh në exchange në Astir, identifikohet autori, arrestohet bashkëpunëtori
28 Qershor, 2023

Policia kërkon bashkëpunimin e qytetarëve për grabitjen e exchange-it Astir: 5-mijë euro për ata që kanë informacione për autorin
24 Qershor, 2023

Tabóla Feed

Most Computer Owners Don't Know This. Do It Today!
This Could Be the Most Important Tip You Read This Year
Analyze Driver Updater | Sponsored
Click Here

Market Wizard Who Predicted 2022 Crash Shares Surprising New Forecast
VisionaryProfit | Sponsored

Lëvizje në Policinë e Shtetit, shkarkohet drejtori në Durrës, ja kush e zëvendësson
Lëvizje në Policinë e Shtetit, shkarkohet drejtori në Durrës, ja kush e zëvendësson
balkanweb.com

If you have a mouse, this game will keep you awake all night long.
Naria Quest | Sponsored

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Prisni qetësinë publike me muzikë të lartë në lokalin që menaxhonte, procedohet penalisht 36-vjeçari
01 Korrik, 2023

10 mijë euro të paguara nga një klient në një muaj e gjysmë/ Shfrytëzonte për prostitucion një 15-vjeçare, arrestohet shqiptari në Francë
01 Korrik, 2023

"Furnizonte" lokalet e plazhit në Golem me kokainë dhe ekstazi, pranga të rëndë (EMRI)
01 Korrik, 2023

U plagos me thikë nga bashkëshorti 1 muaj më parë, ndërron jetë splitë Marjola Myrtollari
01 Korrik, 2023

I vendosën tritol në garazhin e banesës biznesmenit, hanë janë dy 27-vjeçarët ish-futbollistë të shpallur në kërkim (Foto)
01 Korrik, 2023

Vrasja e babë e bir në Shkodër/ Zbardhen detaje nga krimi i rëndë, autorët u zunë pritë në rrugë, 57-vjeçari dyshohet se bashkëpunonte me policinë për...
Senad Nikshaj | 01 Korrik, 2023

KATEGORIA VIDEO

Të maskuar dhe me armë zjarri, tentuan të vidhnin gjatë natës një banesë në Lushnjë, tre në pranga
01 Korrik, 2023

VIDEO/ Kundërofensivë, momenti kur ushtria ukrainase shkatërron tankun rus me simbolin Z
01 Korrik, 2023

Vrasja e babë e bir në Shkodër/ Zbardhen detaje nga krimi i rëndë, autorët u zunë pritë në rrugë, 57-vjeçari dyshohet se bashkëpunonte me policinë për...
Senad Nikshaj | 01 Korrik, 2023

Energjoi Iglesias arkëtrizon Shasbin Skënderbej, përshëndet me simbolin e shqiponjës dhe flet shqip në skenë
01 Korrik, 2023

"Travel Fest Albania" nis maratonën filmike me 3 korrik/ Tirana, Durrësi dhe Gjirokastra mirëpresin mbi 50 autorë të huaj
30 Qershor, 2023

Larg politikës dhe tensioneve/ Rama, Vjosa Osmani dhe Abazovic në Ulqin, koncerti i famës me famë botërore bën bashkë liderët shqiptarë
30 Qershor, 2023

BalkanWeb

FAQET ZYRTARE
TV News24 Live
News24.al
Radio RASH

PRIVATËSIA
POLITIKA E PRIVATËSISË

KONTAKT
redaksia@balkanweb.com

EMISIONE NEWS24
Alert
Autokrosht
Dola ta Ofa
Emisioni Vila 24
Fit Station
Frontline
Kjo Java
Klinika 24
Koha për t'u ngjitur
Me zemër të hapur
Në shtëpizënë
Open
Sport News
Sport News Plus

KATEGORI
Fillimi
Shqipëria
Kosova
Rajoni
Sport
Bota
Kulturë
Metropol
Analiza
Teknologji

MEDIAT E HUAJA
New York Times
Guardian
WEB BBC
WEB CNN
REUTERS
Washington Post
Times Online
Financial Times
WEB Yahoo
WEB MSN
USA Today

© 2023 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.